

RREGULLORJA ZBATUESE NR. 2003/XX
MBI ZBATIMIN E
LIGJIT PËR SKEMËN E NDIHMËS SOCIALE NË KOSOVË

- NUMRI I LIGJIT 2003/16 -

Qeveria e Kosovës,

Në pajtim me kushtet e përfshira në Ligjin e Skemës së Ndhmës Sociale të Kosovës
(2003/16),

dhe

me qëllim të plotësimit dhe të sqarimit të kushteve kyçe të këtij ligji,

dhe

në mënyrë që t'u sigurohen udhëzime administruesve të këtij ligji,

miraton Rregulloren e zbatimit si më poshtë:

Neni 1**Definicionet dhe akronimet (shkurtesat)**

- 1.1 Me 'agjent' është përkufizuar personi i cili është autorizuar nga MPMS-ja që t'i marrë pagesat e NS-së në emër të paraqitësit të kërkesës dhe përcaktimi i tij si agjent është bërë në pajtim me kushtet e Nënndarjes 15.4 dhe 15.5 të kësaj rregullorje zbatuese.
- 1.2 'Komisioni i Ankesave' përkufizohet si komision i ekspertëve, i themeluar nga MPMS-ja, me qëllim të vlerësimit të ankesave me shkrim nga ana e personave që paraqesin kërkesë për ndihmë sociale, të cilët janë të pakënaqur me vendimin e Zyrës së MPMS-së, pas refuzimit të ankesave të shkallës së parë. Komisioni i Ankesave mund të përfshijë Komisionin Mjekësor, i cili ende nuk e ka rishikuar (ekzaminuar) paraqitësin e kërkesës apo ndonjë anëtar të familjes së tij.
- 1.3 Me 'Paraqitës i kërkesës' përkufizohet personi i cili aplikon për NS:
- (i) në emrin e tij personal,
 - (ii) në emrin e tij personal dhe në emër të anëtarëve të tjerë të familjes, ose
 - (iii) në emër të një familjeje tjetër,
- dhe** i cili është përgjegjës për të siguruar se dokumentacioni dhe informatat e dorëzuara në MPMS janë të vërteta dhe korrekte.
- Paraqitësi i kërkesës mund të jetë, por edhe mund të mos jetë anëtar i familjes, në pajtim me kushtet e paraqitura në Nënndarjen 3.7 të kësaj rregullorje zbatuese.
- 1.4 Me 'Pension themelor' përkufizohet pensioni i paguar në pajtim me pensionin themelor, siç përcaktohet në 'Rregulloren nr. 2001/35 mbi pensionet në Kosovë' dhe në 'Ligjin mbi metodologjinë e përcaktimit të nivelit të pensionit themelor në Kosovë dhe përcaktimin e datës së fillimit të dhënies së pensioneve themelore' (Ligji numër 01/2002).
- 1.5 Me 'Certifikatë të lindjes' përkufizohet certifikata e lëshuar nga autoritetet komunale, ku ofrohen detajet e lindjes së paraqitësit të kërkesës dhe/ose anëtarit(anëtarëve) të familjes. Vetëm certifikata zyrtare e cila:
- (i) ofron detajet e prindërve të personit dhe
 - (ii) është certifikatë e lëshuar në formatin e përshkruar nga autoritetet komunale do të jetë e pranueshme për MPMS-në.
- 1.6 'Deklarata e papunësisë' definohet si certifikatë zyrtare:
- (i) ku thuhet se personi i paraqitur, të cilit i është lëshuar certifikata, është regjistruar si i papunë dhe se është duke kërkuar punë dhe
 - (ii) është lëshuar nga ndonjë zyrë për punësim e Departmentit të Punës të MPMS-së ose

nga ndonjë organizatë tjetër e caktuar nga MPMS-ja për lëshimin e certifikatave të tilla.

- 1.7 Me 'certifikatë e vdekjes' përkufizohet certifikata e lëshuar nga autoritetet komunale, në të cilën paraqiten detajet e vdekjes së paraqitësit të kërkesës dhe/ose anëtarit(anëtarëve) të familjes. Vetëm certifikata zyrtare nga autoritetet komunale do të jetë e pranueshme për MPMS-në.
- 1.8 'Personi i varur' definohet në pajtim me paragrafin 1.7 të Ligjit mbi Skemën e Asistencës Sociale në Kosovë. Ky ligj e definojnë si 'person të varur', individin i cili bën pjesë në njërin nga grupet e poshtëshënuara:
- (i) Personat të cilët janë mbi moshën 18 vjeç dhe të cilët kanë të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuara, gjë që i bën ata të paaftë për të punuar punë të shpërblyeshme;
 - (ii) Personat të cilët janë (65) vjeç apo edhe më të moshuar;
 - (iii) Kujdestarët e përhershëm të:
personit (personave) me aftësi përherë të kufizuara,
ose të personit (personave) në moshën 65 vjeç apo mbi moshën 65 vjeç, që kanë nevojë për kujdes të përhershëm,
ose të fëmijës (fëmijëve), nën moshën 5-vjeçare;
 - (iv) personat deri në moshën 14-vjeçare, duke përfshirë edhe moshën 14-vjeçare;
 - (v) personat ndërmjet moshave pesëmbëdhjetëvjeçare (15) dhe tetëmbëdhjetëvjeçare (18), të cilët rregullisht vijojnë shkollimin e mesëm;
 - (vi) Prindërit vetushqyes me së paku një fëmijë nën moshën 15 vjeç.
- Në rastin e mësipërm nën (iii) personi që ka nevojë për kujdes të përhershëm, duhet të ketë aftësi të kufizuara deri në atë shkallë sa që moskujdesja e përhershme për të, paraqet rrezik serioz për sigurinë e tij e madje edhe për jetën e tij. Kujdesi i ofruar duhet të jetë deri në atë masë sa që t'ia pamundësojë personit që ofron këtë kujdes të punësohet.
- 1.9 'Autoritetet përkatëse' përkufizohen si zyra të MPMS-së, ose institucione të tjera të cilat i vendos MPMS-ja në pajtueshmëri me paragrafin e 3-të të kësaj rregullorje zbatuese.
- 1.10 'Aftësi e kufizuar' konsiderohet aftësia e kufizuar që përmbush kushtet e paraqitura në paragrafin e 7-të të kësaj rregullorje zbatuese.
- 1.11 "Pension i aftësisë së kufizuar" përkufizohet çdo pagesë e sigurisë sociale që u bëhet personave të cilët konsiderohen me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i cili drejton skemën e tillë të pagesave.
- 1.12 'Certifikata e shkurorëzimit' është certifikatë zyrtare e lëshuar nga autoritetet komunale, në të cilën jepen detajet e shkurorëzimit të paraqitësit të kërkesës dhe/apo anëtarit (anëtarëve) të familjes. Vetëm certifikata zyrtare në formatin e aprovuar nga autoritetet komunale do të pranohet nga MPMS-ja.
- 1.13 'Certifikata e mjekut' është certifikatë zyrtare e lëshuar nga një mjek që punon në Kosovë dhe i cili është i regjistruar dhe aprovuar nga Ministria e

Shëndetësisë në Kosovë. Certifikata do të jetë në formën e caktuar nga MPMS-ja dhe do të përshkruhet në nënparagrafet 7.4 dhe 7.5 të kësaj rregullorje zbatuese.

1.14 “Komisioni Mjekësor” nënkupton një grup ekspertësh mjekësorë, i formuar ose i miratuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, me qëllim të përcaktimit të gjendjes shëndetësore, duke përfshirë shkallën e gjendjes shëndetësore të çdo personi apo anëtari të familjes, i cili është i përfshirë në Ligjin e NS-së.

1.15 'Punësimi' definohet si punë me kompensim (financiar apo mënyrë tjetër kompensimi, përfshirë të mirat materiale dhe/ose favoret dhe/ose shërbimet dhe/ose këmbimet) në baza të përhershme, të përkohshme apo të rastit. Kjo vlen, pavarësisht nga fakti nëse puna kryhet me apo pa kontratë të punës, kontratë për shërbim, kontratë civile, marrëveshje të tjera komerciale, dhe pavarësisht se a ekziston marrëveshje me shkrim apo e pashkruar.

1.16 Me 'tokë' definohet toka, përfshirë pronën të cilën e posedon paraqitësi i kërkesës dhe/ose familja apo ka në shfrytëzim tokë nga e cila ka dobi materiale. Në atë tokë mund të përfshihet vendbanimi primar (shtëpia) e paraqitësit të kërkesës dhe/ose familjes, e po ashtu mund të përfshihet edhe toka ku nuk ndodhet shtëpia.

1.17 'Certifikatë e kadastrës mbi tokën' është certifikata zyrtare, në të cilën paraqiten detajet e pronës dhe e cila lëshohet nga Drejtoria e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronës në Kosovë.

1.18 'Kujdestar ligjor' është personi i cili është emëruar, sipas ligjit të tanishëm, si kujdestar i personit apo familjes që nuk janë në gjendje vetë të paraqesin kërkesën për ndihmë sociale për shkak të rrethanave që e kanë krijuar nevojën për emërimin e kujdestarit ligjor.

1.19 'Bagëtia' përfshin: lopët, delet, derrat, dhitë, shpesët ose kafshët e tjera, të cilat mbahen për qëllime fitimi.

1.20 'Pagesa e përgjithshme' definohet si pagesë e vetme e cila nuk bëhet më shpesh se një herë në çdo gjashtë muaj.

1.21 'Certifikata e kurorëzimit' është certifikatë zyrtare e lëshuar nga autoritetet komunale, që përmban detajet e martesës së paraqitësit të kërkesës dhe/ose anëtarit (anëtarëve) të familjes. Vetëm certifikata zyrtare në formën e caktuar nga autoritetet komunale do të pranohet nga MPMS-ja.

1.22 'Verifikim i gjendjes materialet' definohet verifikimi nga ana e MPMS-së – në pajtueshmëri me nenin e 8-të të kësaj rregullorje zbatuese – i të hyrave të llogaritshme dhe të pallogaritshme dhe të mirave materiale të llogaritshme dhe të pallogaritshme të paraqitësit të kërkesës, familjes dhe bashkësisë familjare. Në rast se paraqitësi i kërkesës është kujdestar ligjor i familjes, por nuk jeton me atë familje, atëherë do të merren parasysh vetëm të hyrat e llogaritshme dhe të pallogaritshme dhe të mirat materiale të llogaritshme dhe të pallogaritshme të familjes dhe bashkësisë familjare.

1.23 'Automjeti motorik', i shfrytëzuar vetëm nga familja për qëllime shtëpiake dhe që nuk shfrytëzohet për të krijuar të ardhura, definohet si:

- (i) Automjet që shërben vetëm për përdorim personal-privat nga paraqitësi i kërkesës dhe/ose nga familja **dhe** nuk shfrytëzohet assesi për qëllime përfitimi **si dhe** është i regjistruar, taksuar dhe i siguruar në Kosovë si automjet privat, jokomercial. Vetëm një automjet i tillë motorik mund të lejohet në cilindo aplikacion për NS-në.
- (ii) Karroca me motor për invalidë ,apo ndonjë mjet i adoptuar në të cilin mund të ulet vetëm një person, dhe të cilin e shfrytëzon vetëm paraqitësi i kërkesës apo ndonjë anëtar tjetër i familjes, i cili është me aftësi të kufizuara dhe ka nevojë për një karrocë të tillë.

I gjithë dokumentacioni zyrtar që dëshmon se automjeti është i regjistruar, i taksuar dhe i siguruar në Kosovë duhet të dorëzohet së bashku me aplikacionin për AS.

Taxi, autobusi, minibusi, furgoni, makina e transportit, kamioni, traktori, minitraktori, kultivatori, minikultivatori, motoçikleta, apo çfarëdo automjeti tjetër i motorizuar pranohet vetëm si 'automjet motorik i shfrytëzuar vetëm nga familja për qëllime shtëpiake jo për të krijuar të ardhura' sipas Ligji të NS-së dhe një automjet i tillë do të llogaritet si 'e mirë materiale e llogaritshme' sipas nenit të 8-të të kësaj rregullorje zbatuese.

- 1.24 'Jetimi' definohet sipas nenit 1.5 të ligjit të NS-së, si fëmijë të dy prindërit e të cilit kanë vdekur, ose i cili ka lindur nga një prind (vetushqyes), i cili ka vdekur.
- 1.25 ' Person me të meta të rënda dhe me aftësi përherë të kufizuara' definohet: (i) personi me aftësi fizike dhe mendore, në shkallë jo më të vogël se 80%, dhe (ii) dhe aftësia e tillë e kufizuar e bën personin të paaftë për punë në kohën kur ai e paraqet kërkesën dhe për një periudhë vijuese jo më pak se dy vjet, duke filluar menjëherë nga paraqitja e kërkesës për NS.
- 1.26 'Prona' definohet si tokë – përfshirë edhe ndërtesat – në Kosovë të cilat i posedojnë ose i shfrytëzojnë paraqitësi i kërkesës dhe/ose anëtarët e familjes. Banesa-shtëpia primare e paraqitësit të kërkesës dhe/ose familjes do të llogariten si pronë në këtë përkufizim.
- 1.27 'Certifikata e shkollës' është certifikatë e lëshuar nga shkolla e pranuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, ku thuhet se paraqitësi i kërkesës dhe/ose anëtar i familjes vijon mësimin e rregullt në atë shkollë. Vetëm formulari NS*** i bashkangjitur në Shtojcën B mund të përdoret për këtë qëllim.
- 1.28 'Shkolla' definohet si institucion i arsimit, i pranuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë.
- 1.29 'Vetëpunësimi' përkufizohet si punë për përfitime personale – me të holla të gatshme apo shpagim – në çfarëdo prodhimtarie që nuk përfshihet në përkufizimin e punësimit siç është paraqitur në nënenin 1.15 e kësaj rregullorje zbatuese.
- 1.30 “Prindi vetushqyes” përkufizohet në pajtim me nenin 1.6 të Ligjit për NS si prind apo kujdestar ligjor i fëmijës deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, që jeton me fëmijën dhe është përgjegjës i vetëm ligjor dhe financiar i fëmijës.

1.31 'I papunësuar' përkufizohet paraqitësi i kërkesës dhe/ose anëtari (anëtarët) e familjes që nuk janë të punësuar ose të vetëpunësuar dhe janë në kërkim të punës dhe janë të regjistruar në zyrat e tyre lokale për punësim, si të papunë dhe që nuk vijnë ndonjë kurs trajnues dhe nuk marrin pjesë në ndonjë kurs profesional trajnues dhe nuk vijnë rregullisht mësimin në shkollë apo universitet dhe nuk marrin asnjë formë pagese për asnjë formë pune.

1.32 'ILAT' ose 'Benificioni për invalidët e luftës dhe të afërmit e tyre' është benificion që paguhet në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/66.

1.33 Ligji për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë (2003/16) përkufizon edhe termat e tjerë.

1.34 Akronimet (shkurtesat):

'PTh' ka kuptimin Pensioni Themelor, siç përkufizohet më hollësisht në pikën 1.4 të kësaj rregullorje zbatuese.

'PAK' do të thotë Pensioni i Aftësisë së Kufizuar, siç përkufizohet më hollësisht në pikën 1.10 të kësaj rregullorje zbatuese.

'QPS' do të thotë Qendra për Punë Sociale, apo ndonjë njësi e tillë administrative të cilës do t'i caktohen funksionet e Qendrave për Punë Sociale.

'SNV' do të thotë Skema për Nevoja të Veçanta, siç përkufizohet në Ligjin për Skemën Ndhmës Sociale në Kosovë - 2003/16.

'ZQ' do të thotë Zyra Qendrore e Divizionit të pagesave të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, apo ndonjë njësi e tillë administrative të cilës do t'i caktohen funksionet e Divizionit të Pagesave të Mirëqenies Sociale.

'APK' do të thotë Administrata Pensionale e Kosovës, apo ndonjë njësi e tillë administrative të cilës do t'i caktohen funksionet e Administratës Pensionale të Kosovës.

'MPMS' do të thotë: Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, apo ndonjë institucion tjetër i cili do të mund të ishte si pasardhës dhe të cilit do t'i jepeshin funksionet dhe fuqia ligjore sa i përket ndihmës sociale.

'ZR' do të thotë Zyra Rajonale e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

'NS' do të thotë ndihma Sociale, siç parashihet në Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë - 2003/16.

'Ligji i NS' do të thotë Ligji për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë - 2003/16.

'Skema e NS' do të thotë programi i ndihmës sociale, siç përcaktohet në Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë - 2003/16.

'ILAT' do të thotë skema 'Benificionet për invalidët e luftës në Kosovë dhe të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë' (Rregullorja e UNMIK-ut 2000/66).

Neni 2

Struktura organizative e Skemës së Ndhmës Sociale

- 2.1 Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për menaxhimin dhe funksionimin e Skemës për Ndhmë Sociale (përfshirë Skemën për Nevoja të Veçanta).
- 2.2 Skema e NS-së është e organizuar nga MPMS-ja në nivelin lokal, rajonal dhe qendror.
- 2.3 Roli dhe funksionet e zyrave të MPMS-së në secilin nivel, janë të paraqitura në Shtojcën A.
- 2.4 MPMS-ja mund t'i ndryshojë emrin, rolin, detyrat dhe funksionet e këtyre zyrave dhe të personelit, sa herë që konsideron se kjo është e nevojshme. Këto ndryshime do të paraqiten si shtojca të kësaj rregullorje zbatuese.
- 2.5 Kryesuesi i Divizionit të Pagesave të Mirëqenies Sociale i raporton drejtorit të Departamentit të Mirëqenies Sociale dhe mban përgjegjësi për funksionimin e Skemës së NS-së.

Neni 3

Paraqitja e kërkesës për Ndhmë Sociale

- 3.1 Të gjitha kërkesat për ndihmë sociale duhet të paraqiten personalisht nga ana e paraqitësit të kërkesës, ose personit tjetër siç ceket në nenin e 3-të, pika 1.3 të kësaj rregulloreje zbatuese me anë të Formularit për paraqitje të kërkesës për ndihmë sociale (NS****).
- 3.2 Ky formular (shiko kopjen në Shtojcën B) do të mund të merret në zyrat e poshtëshënuara:
 - (i) qendrat për punë sociale,
 - (ii) MPMS/zyrat rajonale të Administratës Pensionale të Kosovës dhe
 - (iii) MPMS/Zyra Qendrore e Administratës Pensionale të Kosovës.
- 3.3 MPMS-ja mund të caktojë vende dhe organizata të tjera ku mund të merren formularët për paraqitjen e kërkesës.
- 3.4 Paraqitjet e kërkesave për NS, të cilat nuk paraqiten në formularin NS****, ose nuk i posedojnë të gjitha informatat dhe dokumentacionin e duhur, do të refuzohen.
- 3.5 Personat që paraqesin kërkesën për ndihmë sociale duhet të jenë së paku 16-vjeçarë.

- 3.6 Me përjashtim të 3.7 në vijim, paraqitësi i kërkesës duhet të jetë anëtar i familjes që e paraqet kërkesën për NS.
- 3.7 Kërkesa për NS mund të bëhet, në emër të familjes, nga kujdestari ligjor i familjes, në rastet kur kujdestari ligjor për atë familje, është emëruar në bazë të ligjeve të zbatueshme në Kosovë që përcakton kujdestaritë e tilla. Mirëpo, në qoftë se kujdestari ligjor është anëtar i personelit të MPMS-së, atëherë paraqitja e kërkesës duhet të bëhet nga pala e tretë, e cila duhet ta informojë kujdestarin ligjor. NS-ja mund t'i paguhet vetëm paraqitësit të kërkesës, çështje e cila trajtohet në vazhdim, në 15.4, 15.5 dhe 15.6.
- 3.8 Anëtarët e personelit të MPMS-së nuk duhet të paraqesin kërkesën apo të bëjnë kompletimin e kërkesës për NS në emër të asnjë familjeje.
- 3.9 Çështje e 3.10 në vazhdim, personi mund ta paraqesë kërkesën e tij në qendrat për punë sociale apo në zyrat tjera të caktuara nga MPMS-ja, në komunën në të cilën jeton. Personat të cilët jetojnë në Prishtinë mund t'i paraqesin kërkesat e tyre në ZQ të APK-së në Prishtinë ose në QPS në Prishtinë.
- 3.10 MPMS-ja mund të caktojë vende apo organizata të tjera ku mund të paraqiten kërkesat për ndihmë sociale. Në këtë kontekst zyrtarët e MPMS për NS, mund t'i vizitojnë paraqitësit e kërkesave të cilët janë persona me aftësi të kufizuara dhe të cilët nuk janë në gjendje t'i paraqesin kërkesat e tyre në zyrat e qendrave për punë sociale dhe t'i pranojnë kërkesat e tyre me rastin e atyre vizitave.
- 3.11 Të gjithë personat që i paraqesin kërkesat e tyre duhet të kenë kartela valide të lëshuara me rastin e regjistrimit të popullsisë nga UNMIK-u (letërnjoftimin e UNMIK-ut me fotografi në të) dhe duhet t'ia tregojnë atë zyrtarit të MPMS-së, me rastin e paraqitjes së kërkesës së tyre
- Zyrtari i MPMS-së duhet t'a fotokopjojë letërnjoftimin e lëshuar nga UNMIK-u dhe duhet t'ia bashkangjes formularit për paraqitjen e kërkesës për NS.
- 3.12 Çdo anëtar i familjes, I cili është i moshës 16-vjeçare apo më i vjetër dhe që është i përmendur në kërkesën e paraqitur, duhet, po ashtu, të posedojë letërnjoftimin valid të lëshuar nga UNMIK-u dhe këto letërnjoftime duhet t'i tregohen zyrtarit të MPMS-së me rastin e paraqitjes së kërkesës për NS nga paraqitësi i kërkesës.
- Zyrtari i MPMS-së duhet ta fotokopjojë letërnjoftimin e lëshuar nga UNMIK-u dhe t'ia bashkangjesë formularit për paraqitjen e kërkesës për NS.
- 3.13 Çdo anëtar i familjes që është më i ri se 16 vjeç, në datën e paraqitjes së kërkesës, duhet të ketë certifikatën e lindjes dhe certifikata duhet t'i tregohet MPMS-së me rastin e paraqitjes së kërkesës për NS nga paraqitësi i kërkesës.

Zyrtari i MPMS-së duhet ta fotokopjojë certifikatën e lindjes dhe t'ia bashkangjesë formularit për paraqitjen e kërkesës për NS.

3.14 Personi që paraqet kërkesën për Ndhimë Sociale duhet ta paraqesë tërë dokumentacionin e duhur, në mënyrë që MPMS-ja të vlerësojë vlefshmërinë e kërkesës së paraqitur.

Dokumentet e tilla duhet të përmbajnë një apo më shumë nga dokumentet e poshtëshënuara, ashtu siç kërkohet nga MPMS-ja:

- (i) certifikata e lindjes për të gjithë anëtarët e familjes nën moshën 16 vjeç;
- (ii) certifikata e vdekjes së të dy prindërve të anëtarit jetim të familjes, ose e partnerit të prindit vetushqyes, në rastet përkatëse;
- (iii) deklarata e papunësisë:
 - (a) për paraqitësin e kërkesës dhe të gjithë anëtarët e familjes që i përkasin moshës prej tetëmbëdhjetë (18) deri në gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç dhe janë të aftë për punë, dhe/ose,
 - (b) për anëtarët e familjes që i përkasin grup-moshës prej pesëmbëdhjetë (15) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe nuk e vijnë rregullisht shkollën e mesme;
- (iv) certifikata e shkurorëzimit e prindit vetushqyes në rastet përkatëse;
- (v) certifikata e mjekut për aftësinë e kufizuar të paraqitësit të kërkesës dhe/ose anëtarëve të familjes – nëse paraqitësi i kërkesës dhe/ose anëtari i familjes paraqesin kërkesën e tyre në baza të aftësisë përherë të kufizuar;
- (vi) certifikata e kadastrës për tokën e paraqitësit të kërkesës dhe të gjithë anëtarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më tepër; këtu duhet të përfshihen gjithashtu detajet e prindërve të vdekur dhe/ose kujdestarëve;
- (vii) dokumenti nga qendra për punë sociale, në komunën ku ka ekzistuar vendbanimi fillestar i paraqitësit të kërkesës dhe anëtarëve të familjes, të cilët janë persona të zhvendosur brendapërbrenda Kosovës, në të cilën thuhet se nuk marrin ndihmë sociale në atë komunë prej nga e kanë prejardhjen;
- (viii) certifikata e kurorëzimit për personat e martuar në familje, posaçërisht për bashkëshortin (bashkëshorten) e paraqitësit të kërkesës, nëse ai person është i përfshirë në kërkesën e paraqitur;
- (ix) certifikata e shkollës për paraqitësin e kërkesës dhe anëtarët e familjes që i përkasin moshave prej pesëmbëdhjetë (15) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe vijnë rregullisht shkollën e mesme;

Dokumentet e taksave, regjistrimit dhe sigurimit për 'automjetin motorik që shfrytëzohet vetëm nga familja për qëllime shtëpiake e jo për të krijuar të ardhura'.

(xi) Nëse ekziston arsyeja, MPMS-ja mund të kërkojë edhe dokumentacion tjetër.

Neni 4

Personat e përzgjedhur

- 4.1 Ndhimja Sociale i paguhet vetëm asaj familjeje që i përmbush kushtet e përzgjedhshmërisë për NS.
- 4.2 'Familja' përkufizohet si:

personi i cili jeton vetëm dhe i cili nuk asnjë anëtar tjetër në bashkësinë familjare,

ose

personi i cili jeton së bashku me bashkëshortin/en *ose* partnerin/en me të cilin bashkëjeton *dhe/ose* prindërit *dhe/ose* fëmijët (përfshirë fëmijët që i takojnë bashkëshortit/es *ose* partnerit/es me të cilin jeton paraqitësi i kërkesës, *dhe/ose* të birësuar *ose* fëmijët e strehuar në mënyrë të ligjshme).

Kështu që familja mund të përbëhet vetëm nga paraqitësi i kërkesës, *ose* nga paraqitësi i kërkesës dhe një, dy, tre apo edhe më tepër anëtarë të familjes, varësisht nga ajo se kush e përbën bashkësinë familjare.

- 4.3 Anëtarët e familjes të cilët janë:

- (i) në moshën gjashtëdhjetë e pesë (65), *ose*
- (ii) të cilët i kanë paraqitur kërkesat për pension të aftësisë së kufizuar,
- (iii) *ose* ata të cilët marrin pensionin e aftësisë së kufizuar, *ose*
- (iv) ata që paguhet nga skema 'Benificionet për invalidët e luftës në Kosovë dhe të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë' (Rregullorja e UNMIK-ut 2000/66),

duhet të përfshihen në formularin për paraqitjen e kërkesës për NS.

Sido që të jetë, anëtarët e familjes që marrin pensionin themelor *ose* pensionin e aftësisë së kufizuar, nuk do të merren parasysh kur të llogaritet madhësia e familjes e cila përcakton shumën e NS-së që duhet paguar.

- 4.4 Personi mund të jetë anëtar vetëm i **një familjeje** dhe nuk mund të llogaritetet si anëtar i familjes tjetër që paraqet kërkesën për ndihmë sociale *ose* që është duke marrë ndihmë sociale.

Neni 5

Vendbanimi

- 5.1 Paraqitësit e kërkesës për NS duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës.

- 5.2 Të gjithë anëtarët e familjes, të cilët janë të përmendur në formularin për paraqitjen e kërkesës, duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës.
- 5.3 Nëse anëtari (anëtarët) e familjes jetojnë jashtë Kosovës, atëherë, ai (ata) person (persona), nuk mund të llogariten si anëtarë të familjes në kërkesën e paraqitur për NS.
- 5.4 Nëse paraqitësi i kërkesës largohet nga Kosova, asaj familjeje do t'i ndërpritet pagesa e NS.
- 5.5 Nëse anëtari i familjes largohet nga Kosova, shuma e pagesës së NS për atë familje do të reduktohet në përputhje me zvogëlimin e madhësisë së saj.
- 5.6 Paraqitësi i kërkesës është i obliguar të informojë qendrën për punë sociale ose zyrën lokale të MPMS-së nëse ai ose ndonjë anëtar i familjes nuk jetojnë në atë komunë gjatë kohës së miratimit të kërkesës për NS, ose gjatë kohës së pagesës së NS-së dhe për atë arsye paraqitja e kërkesës së tyre për NS/pagesa e NS-së do të suspendohet dhe do të shqyrtohet.
- 5.7 Në rastet si në 5.6 më lart, kur MPMS-ja t'i ketë rishikuar rrethanat e reja të paraqitësit të kërkesës, mund të rifillojë pagesën e NS-së, ose të kërkojë nga paraqitësi i kërkesës ta riparaqesë kërkesën e tij në zyrën më të afërt (me vendbanimin e tij) të MPMS-së.
- 5.8 Në rastet si në 5.6 dhe 5.7 kur, pas rishqyrtimit, MPMS-ja nxjerr vendimin se paraqitësi i kërkesës nuk e gëzon më të drejtën për NS, atëherë MPMS-ja mund ta ndërpresë, përfundimisht, pagesën e NS-së.

Neni 6

Kategoritë e familjes

- 6.1 Ekzistojnë vetëm dy kategori të familjeve të përzgjedhura:
- (i) kategoria e parë dhe
 - (ii) kategoria e dytë.
- 6.2 Kërkesat e paraqitura, të cilat nuk i plotësojnë kushtet për kategorinë e parë dhe kategorinë e dytë, të paraqitura në nënnetet 6.3 dhe 6.4 në vazhdim, nuk mund të kualifikohen për ndihmë sociale.
- 6.3 Familje e **kategorisë së parë** është familja në të cilën të gjithë anëtarët e saj janë të varur sipas përkufizimit të dhënë në Nënnetin 1.7 të këtij ligji dhe asnjëri prej tyre nuk është duke punuar.
- 6.4 Familje e **kategorisë së dytë është** familja me një anëtar të familjes të aftë për punë dhe:
- (i) me të paktën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç apo/dhe
 - (ii) që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç ,

Të gjithë anëtarët e familjes, të përfshirë në kategorinë e dytë, duhet të jenë persona të varur sipas përkufizimit në nenin 1.7 të këtij ligji, ose duhet të jenë të regjistruar si të papunësuar në Zyrën e Punësimit të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale .

6.5 Personat e poshtëshënuar nuk kanë drejtë të marrin NS:

(i) Personat që kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe që kanë mbaruar shkollimin e mesëm do të konsiderohen si të aftë dhe në gjendje për të punuar edhe nëse e vazhdojnë shkollimin e rregullt në universitet, ose në ndonjë program trajnues.

(ii) Personat që banojnë, *ose* janë në institucione të tipit të mbyllur apo përkrahen nga ato institucione, ku përfshihen: institucionet psikiatrike, shtëpitë e pleqve, institucionet religjioze, shkollat rezidenciale. Si shtesë, sa i përket Ligjit të NS-së, edhe burgu do të konsiderohet si institucion i tillë.

6.6 Personat e paraqitur në (ii) më sipër nuk duhet të llogariten si anëtarë të familjes sa i përket Ligjit të NS-së.

6.7 Nëse, gjatë periudhës kur familja merr NS, anëtari i asaj familjeje hyn në ndonjë institucion, ose përkrahet nga ndonjë institucion i tillë, siç është paraqitur në nënnenin e sipërshënuar 6.5, paragrafi (ii), atëherë madhësia e familjes do të reduktohet dhe në pajtim me të do të zvogëlohet edhe shuma e NS-së.

6.8 Në qoftë se paraqitësi i kërkesës hyn në ndonjë institucion ose përkrahet nga ndonjë institucion i tillë, siç është paraqitur në nënnenin e sipërshënuar 6.5, atëherë do të anulohet kërkesa e paraqitur dhe duhet të paraqitet kërkesë e re për NS nga një person tjetër. Sidoqoftë, pagesa ekzistuese e NS-së do të bëhet për muajin kur paraqitet ajo ngjarje - për t'iu shmangur vështirësive të panevojshme dhe për t'iu dhënë kohë për paraqitjen e kërkesës së re.

Neni 7

Aftësia e kufizuar

7.1 Personat të cilët janë me të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuara deri në tetëdhjetë (80) për qind, të paaftë për t'u punësuar, mund ta paraqesin kërkesën për ndihmë sociale.

7.2 Personat të cilët janë me të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuara, të paaftë për t'u punësuar, mund të jenë persona të varur nga paraqitësi i kërkesës.

7.3 Personat në 7.1 dhe 7.2 duhet të jenë mbi moshën 16 vjeç dhe nën moshën 65 vjeç.

- 7.4 Secila kërkesë e paraqitur për NS, ku përfshihet personi me aftësi të kufizuara, duhet ta përmbajë një certifikatë mjekësore-zyrtare, në të cilën jepen:
- (i) emri i mjekut,
 - (ii) numri i regjistrimit të mjekut (i regjistruar në Ministrinë e Shëndetësisë),
 - (iii) adresa e mjekut,
 - (iv) emri i personit me aftësi të kufizuara,
 - (v) adresa e personit me aftësi të kufizuara,
 - (vi) data e lindjes e personit me aftësi të kufizuara,
 - (vii) data e ekzaminimit,
 - (viii) lloji i aftësisë së kufizuar (mendore/fizike/ndijore)
 - (ix) data (muaji dhe viti) kur është shfaqur kufizimi i aftësisë,
 - (x) shkaktari i aftësisë së kufizuar,
 - (xi) niveli i aftësisë së kufizuar,
 - (xii) a mund apo nuk mund të punojë personi me aftësi të kufizuara,
 - (xiii) parashikimet se për sa kohë do të zgjasë aftësia e kufizuar.
- 7.5 Mjekët, për këtë qëllim, do të përdorin formularin NS**** për ‘certifikatë të mjekut’ të MPMS-së dhe MPMS vetëm këtë formular do ta pranojë si certificate të vlefshme.
- 7.6 Komisioni i Mjekëve do të vendoset në secilën zyrë rajonale të MPMS-së.
- 7.7 Komisioni i mjekëve do të kryejë ekzaminimin fiziko-mjekësor të secilit anëtar të familjes, i cili pohon se është me aftësi të kufizuara dhe po ashtu pohon se përmbush kushtet e paraqitura në nënnenin e lartshënuar 7.1.
- 7.8 Komisioni i mjekëve do të kërkojë nga secili person i cili i është nënshtruar ekzaminimit, të paraqesë certifikatën e mjekut sipas nënnenit 7.4 të kësaj rregullorje zbatuese.
- 7.9 Komisioni i Mjekëve do të përbëhet së paku nga dy mjekë, të cilët do të paguhen apo kontraktohen nga MPMS-ja dhe që nuk do të kryejnë punë për asnjë person apo organizatë tjetër.
- 7.10 Anëtarët e Komisionit të Mjekëve nuk do të jenë të lejuar të lëshojnë certifikata, si ato që janë të përshkruara në nënnenin e lartshënuar 7.4 .
- 7.11 Secili komision i mjekëve duhet të paraqesë raportin e plotë në lidhje me konstatimet e tyre pas ekzaminimit të paraqitësit të kërkesës dhe/ose anëtarit (anëtarëve) të familjes. Ky raport do të paraqesë gjendjen shëndetësore të personit, rezultatet e ekzaminimit dhe vlerësimin e Komisionit të Mjekëve për shkallën e aftësisë së kufizuar.
- 7.12 Raportet e 7.11 do të barten në ZR të MPMS-së, të cilat do të jenë përgjegjëse për procesimin e kërkesës për NS dhe për të nxjerrë vendimin në lidhje me atë kërkesë të paraqitur.
- 7.13 Një udhëzues mjekësor, që do t’iu ndihmojë komisioneve të mjekëve, do të lëshohet kohë pas kohe nga MPMS-ja.

- 7.14 MPMS-ja mund të kërkoj nga Komisioni i Mjekëve që të rishikojë gjendjen shëndetësore të ndonjë paraqitësi të kërkesës apo të anëtarit (anëtarëve) të familjes, sa herë që MPMS-ja ka arsye të besojë se paraqitësi i kërkesës apo anëtari i familjes nuk i përmbush kushtet e aftësisë së kufizuar në mënyrë që të marrë NS.

Neni 8

Testimi (verifikimi) i gjendjes materiale

- 8.1 Vetëm paraqitësit e kërkesave që i përmbushin kriteret e parqitura në nenin e 3të, nenin e 4-t, nenin e 5-të, nenin e 6-të **dhe** (kur është i aplikueshëm) nenin e 7-të të kësaj rregullorje zbatuese, mund të merren në konsiderim për verifikim të gjendjes materiale.
- 8.2 Testi i verifikimit të gjendjes materiale përbëhet nga dy pjesë: verifikimi i të mirave materiale dhe verifikimi i të hyrave.
- 8.3 Të mirat materiale janë klasifikuar si 'të llogaritshme' dhe 'të pallogaritshme'.
- 8.4 Vetëm të mirat materiale që janë të llogaritshme do të merren parasysh në verifikimin e të mirave materiale.
- 8.5 Vetëm ato kërkesa që do të kalojnë testin për verifikimin e të mirave materiale mund t'i nënshtrohen testit për verifikimin të të hyrave.
- 8.6 Vetëm ato kërkesa që me sukses i **kalojnë që të dy testet**, testin për verifikimin e të mirave materiale dhe testin për verifikimin e të hyrave, mund të kualifikohen për pagesë të NS-së.
- 8.7 Testi për verifikimin e të mirave materiale:

Të mirat materiale të shënuara më poshtë do të merren si **të pallogaritshme** dhe **nuk do të merren parasysh** në testin për verifikimin e të mirave materiale:

- (i) kursimet e anëtarëve të familjes në llogaritë individuale të Sistemit të Kursimeve Pensionale Individuale të Detyrueshme të Kosovës (siç përcaktohet me nenin e 2-të, pikën e 3-të, të Rregullores 2001/35);
- (ii) prona e shfrytëzuar si banim primar i paraqitësit të kërkesës dhe familjes së tij, por me përmasa më të vogla se 0.5 hektarë;
- (iii) toka me përmasa më të vogla se 0.5 hektarë, e cila përfshin shtëpinë për banim primar si në (ii) e lartëshënuar;
- (iv) automjeti motorik i shfrytëzuar vetëm nga familja për nevoja shtëpiake dhe jo për të krijuar të ardhura;
- (v) pagesat e përgjithshme të miratuara nga gjykata, kur ajo pagesë është ekskluzivisht pagesë e ndihmës sociale, që i është miratuar paraqitësit të kërkesës apo familjes së tij, pasi që gjykata ka rishqyrtuar vendimin e MPMS-së në lidhje me atë kërkesë, brenda Ligjit të NS-së.
- (vi) bagëtia, e cila shfrytëzohet vetëm për nevoja shtëpiake të paraqitësit të kërkesës dhe familjes së tij dhe jo për të krijuar të ardhura.

Të mirat materiale, e poshtëshënuara, që do të merren si **të llogaritshme** dhe do të **merren parasysh** në testin për verifikimin e të mirave materiale:

- (vii) pagesat e përgjithshme nga sistemi Individual i Kursimeve Pensionale për pjesëmarësit apo përfituesit e tyre – siç është paraparë në Rregulloren 2001/35;
- (viii) pagesat e përgjithshme sipas mënyrës së kompenzimit për fatkeqësi;
- (ix) pagesat e përgjithshme me vendim të gjykatës apo institucionit përgjegjës për dhënien e këtyre pagesave;
- (x) bizneset private familjare në Kosovë apo në ndonjë shtet tjetër;
- (xi) prona, apo toka në Kosovë, ose në ndonjë shtet tjetër, me mundësi të krijimit të të ardhurave;
- (xii) prona, apo toka, në Kosovë, ose në ndonjë shtet tjetër, e cila është me përmasa 0.5 hektarë apo më shumë;
- (xiii) çdo mjet i motorizuar, i cili i përket paraqitësit të kërkesës apo familjes, **me përjashtim** të mjetit të motorizuar, i cili përdoret nga familja vetëm për qëllime shtëpiake dhe nuk përdoret për të krijuar të ardhura siç është përcaktuar në 1.23 e lartpërmendur;
- (xiv) çdo mjet i motorizuar i dhënë me qira *apo* i marrë me qira nga paraqitësi i kërkesës apo familja, **me përjashtim** të mjetit të motorizuar, i cili përdoret nga familja vetëm për qëllime shtëpiake dhe nuk përdoret për të krijuar të ardhura siç është përcaktuar në 1.23 e lartpërmendur;
- (xv) bagëtia (përfshirë gjedhët, delet, shpesët shtëpiake, derrat,) e që nuk përdoren vetëm për qëllime shtëpiake, jokomerciale nga paraqitësi i kërkesës apo familja;
- (xvi) kapitali i investuar, investimet apo kursimet, me pronësi të plotë apo pjesëshe ndaj pronës e tokës apo biznesit komercial apo ndërmarrjes shtetërore;
- (xvii) makineria - përfshirë pajisjet për punime tokësore, makineria për ndërtim, pajisje për ndërtim të rrugëve, makineria për ndërtim të shtëpive që mund të përdoret për qëllime komerciale,
- (xviii) dhurimet e mjeteve materiale apo pronës të përshkruara në Ligjin mbi ndihmën sociale apo nga kjo rregullore për zbatimin, nga cilido person.

8.8 Vlerësimi i të mirave të llogaritshme materiale

Vlerat vijuese do ta **përjashtojnë** paraqitësin e kërkesës dhe familjen nga pagesa e ndihmës sociale:

- (i) prona e përgjithshme në Kosovë apo ndonjë shtet tjetër, përfshirë edhe vendbanimim primar në Kosovë, që është me përmasa 0.5 hektarë apo më shumë do të trajtohet si vlerë e cila do të llogaritet si e mirë materiale e llogaritshme dhe do ta përjashtojë paraqitësin e kërkesës dhe familjen nga pagesa e ndihmës sociale;
- (ii) cilado formë e pronës apo tokës në Kosovë apo ndonjë shtet tjetër, me përjashtim të vendbanimit primar më pak se 0.5 hektarë në Kosovë, e cila përdoret apo mund të përdoret për qëllime komerciale do ta përjashtojë paraqitësin e kërkesës dhe familjen nga pagesa e ndihmës sociale;
- (iii) çdo mjet i motorizuar, me përjashtim të mjetit të motorizuar i cili përdoret nga familja vetëm për qëllime familjare dhe nuk përdoret për të krijuar të ardhura apo karrocë të motorizuar ose automjet personal për personat me aftësi të kufizuara siç, është përcaktuar në të lartpërmendurën 1.23, do të

- konsiderohet si e mirë materiale e llogaritshme dhe do ta përjashtojë paraqitësin e kërkesës dhe familjen nga pagesa e ndihmës sociale;
- (iv) bagëtia, e cila nuk përdoret vetëm për qëllime familjare jokomerciale nga paraqitësi i kërkesës apo familja, do të llogaritet si e mirë materiale e llogaritshme dhe do ta përjashtojë paraqitësin e kërkesës dhe familjen e nga pagesa e ndihmës sociale;
 - (v) pronësia e plotë apo e pjesshme ndaj pronës, tokës, biznesit komercial apo ndërmarrjes shtetërore, pronësia e pjesshme apo pronësia e plotë nga paraqitësi i kërkesës apo anëtarët e familjes në tokë apo pronë e që nuk është vendbanimi primar i paraqitësit të kërkesës apo familjes, do të llogaritet si e mirë materiale e llogaritshme dhe do ta përjashtojë paraqitësin e kërkesës apo familjen e tij nga pagesa e ndihmës sociale;
 - (vi) makineria - përfshirë pajisjet për punime tokësore, makineria për ndërtim, pajisjet për ndërtim të rrugëve, makineria për ndërtim të shtëpive - të cilat mund të përdoren për qëllime komerciale do të llogariten si të mira materiale e llogaritshme dhe do ta përjashtojnë paraqitësin e kërkesës dhe familjen nga pagesa e ndihmës sociale;

Sipas nënënit 8.7, paragrafëve të lartpërmendur (i) deri në (iv), të mira materiale të llogaritshme vijuese do të **vlerësohen** për qëllime të vlerësimit të përfitimit të paraqitësit të kërkesës dhe familjes:

- (vii) të gjitha pagesat e përgjithshme të paraqitësit të kërkesës dhe/apo anëtarëve të familjes;
- (viii) të gjitha pagesat e përgjithshme me para të gatshme, të cilat mbahen nga paraqitësi i kërkesës dhe/apo familja - këto pagesa të përgjithshme do t'i përfshijnë depozitat bankare apo paratë, të cilat mbahen në forma të ndryshme, siç janë hipoteka, sigurimi, shënimet për huamarrje, kapitali i investuar (duke i përfshirë të gjitha format e drejta);
- (ix) pagesat e përgjithshme nga Sistemi Individial i Kursimeve Pensionale për pjesëmarrësit apo përfituesit e tyre - siç është paraparë në Rregulloren 2001/35;
- (x) pagesat e përgjithshme sipas kompensimit të fatkeqësisë, lëndimit, vdekjes, kontratës së biznesit apo cilitdolloj tjetër të kompensimit me para të gatshme për pronë apo mallra;
- (xi) pagesat e përgjithshme me vendim të gjykatës apo institucionit përgjegjës për dhënien e këtyre pagesave;
- (xii) pagesat e përgjithshme në formë të pensioneve nga cilido institucion brenda Kosovës apo jashtë saj.

Metoda e vlerësimit të të mirave materiale të llogaritshme do të bëhet siç vijon: vlera e shumës së përgjithshme të pagesës(ave) së përgjithshme në të lartpërmendurën (i) deri te (vi) do të ndahet 6 për ta përfituar vlerën neto të vlerës mujore (periudha prej 6 muajve është periudha maksimale për pagesën e kërkesës për ndihmë sSociale) .

Vlera neto e vlerës materiale mujore është shtuar në vlerën neto të pagesës mujore - për ta përcaktuar shumën e cila do të zbritet nga shkalla standarde mujore bruto. Pastaj, nëse produkti i zbritur është më i madh se zero ndihma sociale mund të paguhet.

Në muajin në të cilin pagesat e përgjithshme në të lartpërmendurën (i) deri në (v) janë marrë ato duhet të trajtohen si të hyra materiale të llogaritshme. Për muajt pasues këto vlera të përgjithshme do të trajtohen si të mira materiale të llogaritshme.

- 8.9 të hyrat janë klasifikuar si ‘të llogaritshme’ dhe ‘pallogaritshme’.
- 8.10 e vetmja e hyrë e cila është e llogaritshme do të llogaritet në testin e të hyrave.
- 8.11 vetëm aplikacionet të cilat kanë sukses gjatë testimit të vlerave mund të merren në konsideratë për testin e të hyrave.
- 8.12 vetëm aplikacionet të cilat kanë sukses në të dy testet: testin e të mirave materiale dhe testin e të hyrave mund të kualifikohen për pagesën e ndihmës sociale.
- 8.13 .Testi i të hyrave;

Të hyrat vijuese që do të konsiderohen si **vlera të pallogaritshme** dhe **nuk do të logariten** gjatë testit të të hyrave.

- (i) pagesat e përgjithshme për paraqitësin e kërkesës dhe/apo familjen, të cilat janë llogaritur në testin e verifikimit të të mirave materiale për këtë kërkesë të ndihmës sociale;
- (ii) pagesat e përgjithshme me para të gatshme, të cilat mbahen nga paraqitësi i kërkesës dhe/apo familja, në këto pagesa të përgjithshme përfshihet depoziti bankar apo paratë të cilat mbahen në forma të ndryshme si hipotekë, të cilat janë llogaritur në Testin e verifikimit të të mirave materiale për këtë kërkesë të ndihmës sociale;
- (iii) sigurimi, shënimet për huamarrje, kapitali i investuar (duke i përfshirë të gjitha format e drejta), të cilat janë llogaritur në Testin e verifikimit të të mirave materiale për këtë kërkesë për ndihmë sociale;
- (iv) pagesat e përgjithshme nga Sistemi Individual i Kursimeve Pensionale për pjesëmarrësit apo përfituesit e tyre – siç është paraparë në Rregulloren 2001/35, të cilat janë llogaritur për këtë kërkesë të ndihmës sociale;
- (v) pagesat e përgjithshme sipas kompensimit të fatkeqësisë, lëndimit, vdekjes, kontratës biznesore apo cilitdo lloj tjetër të kompensimit me para të gatshme për pronë apo mallra, të cilat janë llogaritur në testin e verifikimit të të mirave materiale për këtë kërkesë të ndihmës sociale;
- (vi) pagesat e përgjithshme me vendim të gjykatës apo institucionit përgjegjës për dhënien e këtyre pagesave, të cilat janë llogaritur në testin e verifikimit të të mirave materiale për këtë kërkesë të ndihmës sociale;
- (vii) pagesat e përgjithshme në formë të pensioneve nga cilitdo institucion brenda apo jashtë Kosovës, të cilat janë llogaritur në testin e verifikimit të të mirave materiale për këtë kërkesë të ndihmës sociale;
- (viii) pensioni themelor (siç është paraparë me Rregulloren 2001/35);
- (ix) pensioni i aftësisë së kufizuar, siç paraparë në Nënnein 1.3 të ligjit të Ndihmës Sociale dhe Nënnein 1.10 të kësaj rregullorje për zbatim;
- (x) pagesat e njehershme për familjet e përzgjedhshme në ndihmën sociale siç është paraparë në Nenin 11 të Ligjit të ndihmës sociale;
- (xi) produktet shtëpiake të ushqimit për konsum të familjes;
- (xii) huamarrjet apo dhuratat, me përjashtim të të gjitha pagesave në nënnein e lartpërmendura 8.12 (xxxiv) dhe 8.12 (xxxv), që paguhen nga Ministria apo Autoriteti përkatës Qeveritar për paraqitësin e kërkesës apo familjen për qëllim të veçantë të arsimimit formal të paraqitësit të kërkesës apo

anëtarëve të familjes, apo në skemën e strehimit familjar, apo skemën e strehimit të familjeve të refugjatëve nga UNHCR-ja;

Të ardhurat vijuese që do të konsiderohen si **vlera të llogaritshme** dhe **do të merren parasysh** gjatë testit të të hyrave.

- (xiii) pagesat e përgjithshme për paraqitësin e kërkesës dhe/apo familjen, të cilat **nuk** llogariten në testin për verifikimin e të mirave materiale, për këtë kërkesë për ndihmë sociale;
- (xiv) pagesat e përgjithshme me para të gatshme, të cilat mbahen nga paraqitësi i kërkesës dhe/apo familja, në këto pagesa të përgjithshme përfshihet depoziti bankar apo paratë të cilat mbahen në forma të ndryshme si hipotekë, të cilat **nuk** llogariten në testin për verifikimin e të mirave materiale për kërkesën për ndihmë sociale;
- (xv) sigurimi, shënimet për huamarrje, kapitali i investuar (duke i përfshirë të gjitha format e drejta), të cilat **nuk** llogariten në testin për verifikimin e të mirave materiale për këtë kërkesë për ndihmë sociale ;
- (xvi) pagesat e përgjithshme nga Sistemi Individual i Kursimeve Pensionale për pjesëmarrësit apo përfituesit e tyre – siç është paraparë në Rregulloren 2001/35, të cilat **nuk** llogariten për këtë kërkesë për ndihmë sociale;
- (xvii) pagesat e përgjithshme sipas kompensimit të fatkeqësisë, lëndimit, vdekjes, kontratës biznesore apo cilitdo lloj tjetër të kompensimit me para të gatshme për pronë apo mallra, të cilat **nuk** llogariten në testin e testin për verifikimin e të mirave materiale, për këtë kërkesë për ndihmë sociale;
- (xviii) pagesat e përgjithshme me vendim të gjykatës apo të institucionit përgjegjës për dhënien e këtyre pagesave, të cilat **nuk** llogariten në testin e vlerave për këtë aplikacion të ndihmës sociale;
- (xix) pagesat e përgjithshme në formë të pensioneve nga cilido institucion brenda apo jashtë Kosovës, të cilat **nuk** llogariten në testin për verifikimin e të mirave materiale për këtë kërkesë për ndihmë sociale;
- (xx) të ardhurat nga huamarrja apo qiramarrja;
- (xxi) paratë e dërguara nga personi brenda Kosovës apo jashtë Kosovës;
- (xxii) përfitimet e dhuruara aplikuesit apo anëtarëve të familjes, sipas Rregullores 2000/36, e cila administron Skemën e Përfituesve të Invalidëve të Luftës dhe të Afërmve të tyre, të cilët kanë vdekur nga pasojat e konfliktit të armatosur në Kosovë;
- (xxiii) pagesat e përgjithshme nga Sistemi Individual i Kursimeve Pensionale për pjesëmarrësit dhe pensioneve suplementare apo të punëdhënësit –siç është paraparë në Rregulloren 2001/35;
- (xxiv) pagesat e marra si rezultat i pjesëmarrjes në ndonjërin prej skemave, përfshirë edhe programet trajnuese, të cilat i përkrahin personat e papunë;
- (xxv) pagesat për personat e papunë, të cilat kryhen nga ndonjëra ministri, agjenci, komunë apo burim tjetër zyrtar në Kosovë;
- (xxvi) pensionet të cilat merren jashtë Kosovës;
- (xxvii) interesi apo fitimi i marrë nga cilido burim;
- (xxviii) MPMS-ja mund t'i definojë burimet e tjera të të hyrave të llogaritshme dhe këto në trajtë shtojce do të jepen në këtë rregullore për zbatim);

8.14. Vlerësimi i vlerës së të hyrave të llogaritshme

Metoda e vlerësimit të të hyrave të llogaritshme do të bëhet siç vijon: vlera e shumës së përgjithshme të hyrave të llogaritshme në të lartpërmendurën (xiii) deri në (xxx)

do të ndahet ose pjesëtohet me 6 për ta përfituar vlerën neto të vlerës mujore (periudha prej 6 muajve është periudha maksimale për pagesën e kërkesës për ndihmë sociale).

8.15. Llogaritja e vlerës së pagesës së ndihmës sociale

- (i) Madhësia e familjes e cila do të merret gjatë përcaktimit të shkallës standarde mujore bruto, e cila do të aplikohet do të sigurohet nga zvogëlimi i numrit të personave në familje nga këta anëtarë të familjes:
- (a) ata që janë të moshës gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare apo më të moshuar
- (b) ata që kanë aplikuar për pensionin e aftësisë së kufizuar dhe ku vendimi për pensionin e tyre të aftësisë së kufizuar nuk është dhënë ende, apo
- (c) ata që marrin pensionin e aftësisë së kufizuar.
- (ii) Vlera neto e vlerës mujore është shtuar në vlerën neto të të hyrave mujore - për ta përcaktuar shumën e zbritur nga shkalla standarde mujore bruto, e cila aplikohet për madhësinë e familjes.
- (iii) Shuma për vlerën neto të vlerës mujore dhe shuma për vlerën neto të pagesës mujore do të zbriten nga shkalla standarde mujore bruto.
- (iv) Nëse produkti (iii) e ka vlerën më të madhe se zero atëherë ajo do të jetë vlera, e cila do t'i paguhet paraqitësit të kërkesës për ndihmë sociale, sipas vlerës minimale prej 10 euro - siç është paraparë në Nënnein e më poshtëm 10.4.
- (v) Nëse produkti (iii) është i batartë apo më pak se zero, atëherë do të refuzohet kërkesa për ndihmë sociale.

Shembulli 1: Është përgatitur aplikacioni për familjen 5-anëtarëshe. Njëri nga këta 5 anëtarë të familjes e merr pensionin themelor.

Vlera neto e vlerës mujore	=15 euro
Vlera neto e pagesës mujore	= 7 euro

	22 euro

shuma e vlerave neto të vlerës mujore dhe vlerës neto të pagesës mujore është 22 euro.

Shkalla standarde mujore bruto, e cila aplikohet për familjen 4-anëtarëshe (duke e zbritur anëtarin e famijes i cili merr pension themelor) është 60 euro.

Pra, vlera e cila paguhet për ndihmë sociale e për këtë familje është 38 euro (60 euro minus 22 euro).

Shembulli 2: Është përgatitur aplikacioni për familjen 3-anëtarëshe.

Vlera neto e vlerës mujore	=25 euro
Vlera neto e pagesës mujore	= 27 euro

	52 euro

Shuma e vlerave neto të vlerës mujore dhe vlera neto e pagesës mujore është 52 euro.

Shkalla standarde mujore bruto, e cila aplikohet për familjen 3-anëtarëshe është 55 euro.

Pra, vlera e cila paguhet për ndihmë sociale e për këtë familje është 10 euro (55 euro minus 52 euro, sipas minimumit prej 10 eurove)

Shembulli 3: Është përgatitur aplikacioni për familjen 4-anëtarëshe.

Vlera neto e vlerës mujore	=00	euro
Vlera neto e pagesës mujore	= 60	euro

	60	euro

Shuma e vlerave neto të vlerës mujore dhe vlera neto e pagesës mujore është 60 euro.

Shkalla standarde mujore bruto, e cila aplikohet për familjen 4-anëtarëshe është 60 euro.

Pra, aplikacioni do të refuzohet (60 euro minus 60 euro e barabartë me zero)

Shembulli 4: Është përgatitur aplikacioni për familjen 7-anëtarëshe.

Vlera neto e vlerës mujore	=00	euro
Vlera neto e pagesës mujore	= 10	euro

	10	Euro

Shuma e vlerave neto të vlerës mujore dhe vlera neto e pagesës mujore është 10 euro.

Shkalla standarde mujore bruto, e cila aplikohet për familjen 3-anëtarëshe është 75 euro.

Pra, familjes do t'i paguhet vlera prej 65 eurosh (75 euro minus 10 euro).

8.16 *Statusi i vlerave dhe të hyrave, i përcaktuar në nënnetet vijuese mund të mos ndryshojë, përveç ndryshimit të Ligjit të ndihmës sociale (2003/16), i cili pastaj duhet të miratohet nga Parlamenti i Kosovës.*

(a) nënneti 8.7, paragrafët (i), (iv), (vii), (x), (xi), (xii), (xiii), (xiv), (xvii)

(b) nënneti 8.13, paragrafët (i), (ii), (iii), (viii), (ix), (x), (xi), (xii), (xiii),

(xiv), (xv), (xvi), (xx), (xix), (xxi), (xxii), (xxiii), (xxvi), (xxvii)

Neni 9

Vendimi

9.1 Autoriteti për marrjen e vendimeve lidhur me kërkesën për ndihmë sociale është i nëpunësve të ndihmës sociale në çdo QPS.

- 9.2 Vendimet për secilin aplikacion të ndihmës sociale do të shënohen në formën e vendim të ndihmës sociale (shih Shtojcën B). Një kopje e kësaj do t'i dorëzohet paraqitësit të kërkesës.
- 9.3 Duhet të merret vendimi dhe t'i komunikohet paraqitësit të kërkesës me shkrim brenda afatit prej 45 ditëve pas pranimit të aplikacionit të ndihmës sociale të kompletuar në mënyrë të rregullt.
- 9.4 Paraqitësve të kërkesave duhet t'u dorëzohet njoftimi me shkrim për vendimin mbi ndihmën sociale, të informohen për të drejtat e tyre për t'u ankuar lidhur me cilindo vendim me të cilin ata nuk pajtohen. Me këtë ata do të informohen se si, ku, kur dhe kujt mund t'ia adresojnë këtë ankesë.

Neni 10

Shuma e ndihmës sociale

- 10.1 Vlerat maksimale (shkalla standarde mujore bruto) të normave për pagesën e ndihmës sociale për vitin 2003 janë:

Numri i anëtarëve të familjes	shkalla standarde mujore-euro
Familja me një (1) anëtar	35
Familja me dy (2) anëtarë	50
Familja me tre(3) anëtarë	55
Familja me katër (4) anëtarë	60
Familja me pesë (5) anëtarë	65
Familja me gjashtë (6) anëtarë	70
Familja me shtatë (7) apo më shumë anëtarë	75

- 10.2 Këto vlera mund të ndryshohen çdo vit nga Qeveria, sipas dispozitave në nenet 8 dhe 12 të Ligjit të ndihmës sociale.
- 10.3 Çdo amendament i tillë do të përcaktohet nga MPMS-ja gjatë korrigjimit të Rregullores për zbatim.
- 10.4 Kalkulimi i vlerës së ndihmës sociale: vlera e pagesës mujore të ndihmës sociale do të paguhet për aplikacionin e sukseshëm dhe do të jetë në përputhje me dispozitat e Nënënit 8.15 të kësaj rregullorje për zbatim.

Neni 11

Periudha për marrjen e ndihmës sociale

- 11.1 Çdo kërkesë e paraqitur për ndihmë sociale do të jetë e vlefshme për periudhën gjashtë (6) mujore, pas së cilës duhe të përgatitet kërkesa e re për ndihmë sociale.

11.2 Pavarësisht nga Nënenni 11.1, pagesat e ndihmës sociale mund të pezullohen apo ndalen gjatë atyre gjashtë (6) muajve nëse paraqitësi i kërkesës, apo anëtar i familjes, i shkel kushtet për pagesën e ndihmës sociale.

Neni 12

Kontrolli dhe inspektimi

- 12.1 MPMS-ja do ta miratojë një plan të kontrollit që në mënyrë sistematike të sigurojë saktësi të pagesave, vendime korrekte dhe t'i parandalojë mashtimet dhe/ose korrupsionin në kërkesat për ndihmë sociale. Një kopje e këtij plani të kontrollit do t'i dorëzohet Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë. Ky plan i kontrollit do të plotësohet çdo vit.
- 12.2 Ky plan i kontrollit do të zbatohet nga çdo zyrë e MPMS-së dhe do të ketë për qëllim kontrollin, shqyrtimin dhe inspektimin në terren si dhe do të përcaktohet për çdo zyrë të MPMS-së.
- 12.3 MPMS-ja do ta themelojë sistemin mbledhjes së informatave lidhur me efikasitetin e zbatimit të planit të kontrollit në çdo zyrë të MPMS-së.
- 12.4 Çdo tre muaj MPMS-ja do ta publikojë përmbledhjen e rezultateve nga plani i kontrollit. Një kopje e kësaj përmbledhjeje do t'i dorëzohet Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave.
- 12.5 MPMS-ja do t'i autorizojë nëpunësit për t'i udhëhequr kontrollet sistematike ndaj paraqitësit të kërkesës, apo familjes, e cila paraqet kërkesën për pagesën e ndihmës sociale - me qëllim të verifikimit të informatës apo dokumenteve të dorëzuara në kërkesën për ndihmë sociale. Këto kontrolle i përfshijnë edhe vizitat në shtëpinë e paraqitësit të kërkesës, shtëpinë e familjes, vendin ku ka qenë i punësuar më parë apo në vende të tjera (përfshirë fermat, institucionet financiare, lokalet komerciale) për të cilat MPMS-ja konsideron se mund t'i ndihmojnë gjatë shqyrtimit të aplikacionit të ndihmës sociale.
- 12.6 MPMS-ja nuk duhet ta informojë paraprakisht lidhur me kontrollin paraqitësin e kërkesës, anëtarët e familjes apo ndonjë person ose organizatë tjetër.
- 12.7 Kontrolli i lartpërmendur mund të bëhet vetëm gjatë ditës (jo para agimit apo perëndimit të diellit).
- 12.8 Pasi që të autorizohen nëpunësit nga MPMS-ja për t'i ndërmarrë vizitat kontrolluese të përshkurara në të lartpërmendurën 12.5, autorizimi u është dhënë atyre për atë kohë, do të thotë se ata nuk duhet të pajisen me autorizime të veçanta për secilën vizitë apo kontroll të cilin e kryejnë.
- 12.9 Nëpunësit e MPMS-së, të cilët i bëjnë këto vizita, sipas të lartpërmendurës 12.5, duhet të kenë identifikimin zyrtar të MPMS-së gjatë vizitave apo kontrolleve.
- 12.10 Nga paraqitësit e kërkesave apo anëtarët e familjes të cilët janë të papunë në çdo kohë gjatë periudhës së paraqitjes së kërkesës mund të kërkohet të ofrojnë fakte se ata vazhdojnë të mbeten të papunë dhe se pandërprerë kërkojnë punësim apo vetëpunësim.
- 12.11 Paraqitësit e kërkesave apo anëtarët e familjes të cilët e kanë refuzuar ofertën për punësim apo vetëpunësim nuk do ta gëzojnë të drejtën e pagesës së ndihmës sociale.

Neni 13

- 13.1 Në rastet e dëshmisë së rreme, apo dështimit të zbulimit të informatave, dhënies së informatave të rreme, obstrukcioneve ndaj MPMS-së ose autoritetit përkatës do të merren masa nga MPMS-ja dhe/apo autoriteti përkatës për rimarrjen e shumave të paguara të ndihmës sociale për të cilat nuk ka patur të drejtë..
- 13.2 Në rastet e dëshmisë së rreme, dështimit të zbulimit të informatave, dhënies së informatave të rreme, obstrukcionit ndaj MPMS-së apo autoritetit përkatës do të ndërpritet aplikacioni i ndihmës sociale dhe nuk do të bëhet pagesa e mëtejme.
- 13.3 Në rastet e përfshira nga nënënetet e lartpërmendura 13.1 dhe 13.2 paraqitësi i kërkesës duhet ta kthejë shumën brenda 3 muajve, me para të gatshme, te nëpunësi për financa i MPMS-së në Zyrën kryesore të Divizionit të Pagesave të Mirëqenies Sociale.
- 13.4 Divizioni i Pagesave i Mirëqenies Sociale do ta themelojë një mekanizëm të sigurt për t'i mbledhur dhe për t'i shënuar këto pagesa të tepërta.
- 13.5 Divizioni i Pagesave i Mirëqenies Sociale do ta publikojë informatën mbi shlyerjen e këtyre borxheve të përfshira në nënënetin e lartpërmendur 13.3. Kjo informatë do të përfshihet në planin e kontrollit të caktuar në nënënetin e lartpërmendur 12.1.

Neni 14

Shqyrtimet dhe ankesat

- 14.1 Paraqitësi i kërkesës, i cili mendon se vendimi zyrtar lidhur me aplikacionin e tij për ndihmë sociale është i padrejtë mund të dorëzojë ankesë me shkrim – duke e shpjeguar qartazi arsyen për të cilën ai mendon se vendimi është i padrejtë - në zyrën e drejtorit të MPMS-së, ku fillimisht janë përgatitur aplikacionet e ndihmës sociale.
- 14.2 Këto ankesa (si në 14.1) duhet të dorëzohen jo më vonë se katërbëdhjetë (14) ditë pasi që aplikuesi ta marrë vërtetimin për vendimin e MPMS-së.
- 14.3 Zyrja e MPMS-së, e cila e përgatit vendimin e parë duhet ta shqyrtojë ankesën dhe ta informojë me shkrim paraqitësin e kërkesës për vendimin e saj lidhur me ankesën jo më vonë se njëzet e një (21) ditë pas pranimit të ankesës. I njëjti nëpunës, i cili e ka përgatitur vendimin e parë nuk duhet ta shqyrtojë ankesën.
- 14.4 Aplikuesi, i cili nuk është i kënaqur me vendimin lidhur me ankesën e tij, sipas pikës së lartpërmendur 14.3, ankesën tjetër me shkrim mund ta adresojë – duke e shpjeguar qartë arsyen për të cilën ai mendon se vendimi është i padrejtë - te Komisioni për Ankesa në MPMS.
- 14.5 Këto ankesa (si në 14.4) duhet të dorëzohen jo më vonë se katërbëdhjetë (14) ditë pasi që personi i cili parashtron ankesën e merr vërtetimin lidhur me vendimin e ankesës sipas nënënetit 14.3.
- 14.6 Komisioni për Ankesa do t'i shqyrtojë ankesat dhe do ta informojë personin i cili e parashtron ankesën me shkrim lidhur me vendimin e Komisionit të Ankesave jo më vonë se njëzet e një (21) ditë pas pranimit të ankesës.
- 14.7 Në rastet kur ankesa ka të bëjë me rezultatet e kontrollit mjekësor nga Komisioni i Mjekëve, atëherë Komisioni për Ankesa do të kërkojë një komison tjetër të mjekësh nga MPMS-ja për ta shqyrtuar aspektin mjekësor të ankesës.

- Ky komision mjekësor do të kërkojë nga presoni i cili e parashtron ankesën që ta bëjë edhe një kontroll mjekësor.
- 14.8 Rezultati i kontrollit mjekësor do t'i dorëzohet Komisionit për Ankesa, i cili pastaj do ta lëshojë një vendim, sipas pikës së lartpërmendur 14.6.
 - 14.9 Paraqitësi i kërkesës, i cili është i cenuar në mënyrë direkte nga vendimi i Komisionit për Ankesa, ka të drejtë të kërkojë shqyrtimin e vendimit në gjykatë.
 - 14.10. Gjykata do ta informojë MPMS-në për secilin rast që duhet ta shqyrtojë. Kjo informatë do t'i dorëzohet MPMS-së në kohë të përshtatshme për t'ia mundësuar MPMS-së që të jetë prezente gjatë seancës gjyqësore.
 - 14.11 Për secilin rast që kalon në gjykatë MPMS-ja do të mbajë shënime në zyrat rajonale dhe në Zyrën kryesore për ankesat e drejtuara në gjykatë.
 - 14.12 Gjatë shqyrtimit të vendimit të MPMS-së, gjykata do t'i marrë parasysht direktivat e Ligjit të ndihmës sociale dhe të Rregullores për zbatimin si dhe të udhëzimeve menaxhuese, të cilat e shoqërojnë Ligjin e ndihmës sociale.
 - 14.13 Nëse vendimi nga gjykata nuk është i favorshëm për MPMS-në, atëherë MPMS-ja mund të parashtrorë ankesë për atë vendim në Gjykatën e Lartë. Vendimi për ta partashtruar këtë ankesë është kompetencë e drejtorit të Departamentit të Mirëqenies Sociale në MPMS-së, në konsultime me sekretarin e përhershëm të MPMS-së.
 - 14.14. Në rast se MPMS-ja mendon që vendimi i Gjykatës kërkon ndryshime në Ligjin e ndihmës sociale, atëherë ministri mund t'i propozojë këto ndryshime.
 - 14.15. Gjatë periudhës së procesimit të ankesës vendimi i cili ka rezultuar me ankesë do të mbetet në fuqi.
 - 14.16. Kur ankesa është e sukseshme, sipas pikave të lartpërmendura 14.3 apo 14.6 apo 14.8, pagesa e ndihmës sociale do të bëhet sipas vendimit të shqyrtuar nga zyra e MPMS-së apo Komisioni për Ankesa.

Neni 15

Pagesat

- 15.1 Pagesa e ndihmës sociale bëhet çdo muaj.
- 15.2 Pagesa e ndihmës sociale do të bëhet me para të gatshme apo përmes xhirollogarisë bankare të paraqitësit të kërkesës – sipas marrëveshjeve të MPMS-së me organizatat të cilat ofrojnë shërbime të pagesave.
- 15.3 Sipas pikave të lartpërmendura 15.4 dhe 15.5, shuma e ndihmës sociale do t'i paguhet vetëm paraqitësit të kërkesës.
- 15.4 Në rastet e veçanta kur paraqitësi i kërkesës nuk ka mundësi që personalisht ta marrë pagesën (kur paraqitësi i kërkesës është i sëmurë apo i penguar për shkak të çështjes së sigurisë, për shembull) paraqitësi i kërkesës mund të kërkojë që ta emërojë një person të autorizuar për ta marrë pagesën e tij.
- 15.5 Nëse paraqitësi i kërkesës dëshiron që ta emërojë një person të autorizuar duhet që për këtë të marrë leje nga MPMS-ja. Kjo kërkesë duhet të bëhet në formën 'zyrtare për emërimin e personit të autorizuar (agjentit)' (shih kopjen në Shtojcën B) dhe, nëse MPMS-ja e pranon kërkesën, MPMS-ja do ta informojë me shkrim paraqitësin e kërkesës se i është emëruar agjenti. Në të gjitha rastet kur është emëruar agjenti paraqitësi i kërkesës do t'i mbajë përgjegjësitë dhe obligimet të cilat zbatohen për paraqitësin e kërkesës dhe që janë të përcaktuara në Ligjin e ndihmës sociale dhe në Rregulloren për zbatim. Të gjithë personat e autorizuar, sipas këtij nënëni, duhet të kenë letërnjoftim valid të UNMIK-ut.
- 15.6 Nëse MPMS-ja nuk e refuzon kërkesën për emërimin e personit të autorizuar, MPMS-ja do ta informojë paraqitësin e kërkesës me shkrim.

- 15.7 Aplikuesit për të cilët MPMS-ja mendon se janë paguar në mënyrë jokorrekte nga ndihma sociale do të informohen për këtë fakt me shkrim nga MPMS-jabrenda njëzet e një (21) ditëve pasi që MPMS-ja të dijë pagesën jokorrekte.
- 15.8 Kur aplikuesi është paguar pak, si në pikën e lartpërmendur 15.7, MPMS-ja do t'ia paguajë paraqitësit të kërkesës - brenda dyzet (40) ditësh – vlerën e shumës së paguar më pak.
- 15.9 Kur paraqitësi i kërkesës është paguar më shumë si në pikën e lartpërmendur 15.7 MPMS-ja do të kërkojë nga paraqitësi i kërkesës që t'ia kthejë - brenda dyzet (40) ditësh – vlerën e paguar më shumë.
- 15.10 Kur pagesa e tepërt, si në pikën e lartpërmendur 15.6, ka rezultuar pas shqyrtimit apo kontrollit, sipas nënënit 12, atëherë, në bazë të pikës 15.11, shuma e pagesës së tepërt do të kalkulohet pas datës së shqyrtimit apo kontrollit.
- 15.11 Kur pagesa e tepërt, si në pikën e mësipërme 15.7, ka rezultuar për arsye se paraqitësi i kërkesës, anëtari i familjes, personi i autorizuar, apo ndonjë person tjetër i lidhur me aplikacion dhe që vepron me vetëdije APO pëlqim të paraqitësit të kërkesës apo familjes, ka:
- (i) kryer mashtrim me paramendim, apo
 - (ii) fshehur informatën, apo
 - (iii) ka dhënë informata të rreme, apo
 - (iv) ka penguar MPMS-në gjatë ndërmarrjes së kontrollit dhe shqyrtimit, apo
 - (v) ka penguar MPMS-në për marrjen e vendimit të saktë për kërkesën për ndihmë sociale,

atëherë,

Pagesa e tepërt do të kalkulohet prej datës kur paraqitësi i kërkesës, anëtari i familjes, personi i autorizuar, apo personi në lidhje me aplikacion ka kryer një akt të tillë si në pikat e lartpërmendura (i) dhe (v).

- 15.12. Në rastin kur mendohet se pagesa e tepërt është bërë për shkak të veprimeve të përshkruara në pikën e lartpërmendur 15.1 do të aplikohen direktivat e nenit të 13-të të kësaj rregullorje për zbatim.

Neni 16

Besueshmëria e informatave personale

- 16.1 MPMS-ja dhe autoritetet e përkatëse nuk duhet t'i ndajnë informatat e mbledhura nga paraqitësit e kërkesave me ndonjë organizatë apo autoritet tjetër, përveç për qëllim të verifikimit të të dhënave të aplikacionit për zbulimin e mashtimit apo të korrupsionit.
- 16.2 Në rastet e veçanta informata mund të ndahet me trupa të tjerë publikë, me vendim të zyrës kryesore të MPMS-së, për mundësimin e bursave, subvencioneve, pagesave apo përfitimeve të dhuruara, të cilat u dhurohen personave brenda familjes. Këto kërkesa mund të merren në konsideratë vetëm atëherë kur ka bazë specifike staturore për ndonjë bursë të posaçme, subvencion, pagesë apo përfitim të dhuruar dhe kur kjo bursë, subvencion, pagesë apo përfitim i dhuruar nuk është në kundërshtim me synimin e kësaj skeme të ndihmës sociale dhe kur efekti i saj nuk do të rezultojë me përjashtimin e familjes përfituese nga përzgjedhshmëria e vazhdueshme në ndihmën sociale sipas këtij ligji.

16.3 Drejtori i Departamentit të Mirëqenies Sociale në Zyrën kryesore të MPMS-së do t'i shqyrtojë të gjitha kërkesat për informatat të cilat duhet ndarë dhe do të marrë vendime lidhur me këto kërkesa.

Neni 17

Skema e Nevojave të Veçanta

- 17.1 Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale mund të bëjë përgatitje për dispozitat e rasteve emergjente dhe ofrimin e përkrahjes së menjëhershme për t'i plotësuar 'nevojat e veçanta', të cilat nuk ofrohen në këtë ligj.
- 17.2 Nevoja e veçantë është definuar si: momentale, e njëhershme, e jashtëzakonshme dhe jo e vazhdueshme. Shembujt e nevojave të veçanta përfshijnë: shpezimet për varrimin të anëtarit të familjes, nevojat emergjente për ushqim apo strehim gjatë vërshimeve apo tërmetit, humbja apo shkatërrimi i karburanteve për ngrohje
- 17.3 Nëse nevoja e njëjtë pason gjatë periudhës së 12-muajshe, atëherë përkrahja nuk do të ofrohet sipas këtij neni.
- 17.4 MPMS-ja, në nivelin e QPS-së, do ta vlerësojë dhe administrojë ofrimin e kësaj përkrahjeje emergjente.
- 17.5 Familja apo individit mund të kërkojnë përkrahje pavarësisht se a janë apo nuk janë ata përfitues të pagesës së ndihmës sociale.
- 17.6 Familja apo individit nuk mund të kërkojnë përkrahje për nevojën e njëjtë emergjente në më shumë se një zyrë të MPMS-së.
- 17.7 Vetëm kryesuesi i familjes mund të kërkojë përkrahje në çdo kohë. Pagesat e ndara për individin apo anëtarët e familjes nuk lejohen.
- 17.8 Buxheti për këtë skemë do të ndahet në nivelin e QPS-ve. Vlera e buxhetit të ofruar për çdo QPS do të bazohet në numrin e popullatës të cilin e mbulon QPS-ja. Kjo informatë do të ofrohet nga Zyra Statistikore e Kosovës dhe/ apo njësia makroekonomike në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave.
- 17.9 Familjet të cilat kanë biznese komerciale apo kanë të ardhura të përgjithshme familjare (përfshirë pagesat e mirëqenies sociale nga MPMS-ja) më të mëdha se 150 euro për muaj nuk do të përfitojnë nga Skema për Nevojave të Veçanta.
- 17.10 Pagesa maksimale për paraqitësin e kërkesës, sipas kësaj skeme, do të jetë 100 euro.
- 17.11 MPMS-ja do të kërkojë që paraqitësit e kërkesave ta plotësojnë dhe ta kompletojnë formën për paraqitje të kërkesës, para se të merret vendimi për pagesë.
- 17.12 MPMS-ja do të kërkojë vërtetim zyrtar të dokumenteve nga paraqitësit e kërkesave për ta përkrahur aplikacionin e tyre për pagesë sipas dispozitave të Skemës së Nevojave të Veçanta.
- 17.13 Buxheti maksimal, i cili do të përcaktohet për një vit për këtë skemë, do të jetë 500.000 euro. Çdo rritje e këtij buxheti do të kërkojë marrëveshje paraprake me shkrim nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 18

Menaxhimi dhe financimi i Skemës së Ndihmës Sociale

18.1 Kërkesat e MPMS-së dhe obligimet e saj për të vepruar së bashku me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë në këtë çështje, janë përcaktuar në nenin e12-të të këtij ligji për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë (2003/16).

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore për zbatim do të hyjë në fuqi më 1 dhjetor 2003.